

VENDIM
Nr. 324, datë 2.6.2021

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË VENDIMIN NR. 230, DATË 17.4.2019,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR SHPALLJEN, KATEGORIZIMIN DHE
EMËRTIMIN E PORTIT TË LLOJIT MBM, NË PORTO-ROMANO, DURRËS,
‘PORT I HAPUR PËR TRAFIK NDËRKOMBËTAR’”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 7, të nenit 18, të ligjit nr. 9251, datë 8.7.2004, “Kodi Detar i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 230, datë 17.4.2019, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Kudo në përmbajtje të vendimit, pas fjalëve “... ligji nr. 104/2015 ...” shtohet fjala “ ... i ndryshuar ...” dhe pas fjalëve “ ... marrëveshjes koncesionare ...” shtohet fjala “... e ndryshuar ...”.

2. Shkronjat “a” dhe “b”, të pikës 1, ndryshohen, si më poshtë vijon:

a) Koordinatat gjeografike	Pika A: N- 41° 22'18.532" E- 19° 23'31.052" Pika B: N- 41° 21'48.277" E- 19° 23'46.517" Pika C: N- 41° 21'36.625" E- 19° 23'6.361" Pika D: N- 41° 22'6.877" E- 19° 22'50.891" Pika P1: N- 41° 22'32.520" E- 19° 25'19.200" Pika P2: N- 41° 22'25.07148" E- 19° 24'49.41114" Pika P3: N- 41° 22'33.29830" E- 19° 25'18.43707" Pika P4: N- 41° 21'49.92000" E- 19° 24'32.30000" Pika P5: N- 41° 22'50.48000" E- 19° 24'35.27000" Pika P6: N- 41° 22'15.47132" E- 19° 25'06.45369" Pika P7: N- 41° 22'08.19861" E- 19° 24'47.41062" Pika P8: N- 41° 22'07.89630" E- 19° 24'43.12646" Pika P9: N- 41° 22'09.16808" E- 19° 24'38.71361" Pika P10: N- 41° 22'12.34902" E-19° 24'34.95584" Pika P11: N- 41° 22'16.33018" E- 19° 24'33.96351"
b) Veprimtaria detare	Ngarkim-shkarkim i mjeteve lundruese që transportojnë naftë, gaz dhe nënproduktet e tyre, si dhe mallra të tjera, në përputhje me parashikimet e marrëveshjes koncesionare, të ndryshuar, të miratuar me ligjin nr. 104/2015, të ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe